

Mirënjojje nga gazeta **Zani i Malsisë**



Gjekë Marinaj
Ambasador i Kulturës
Shqiptare në SHBA

Mirënjohje nga gazeta **Zani i Malsisë** SOT PERVJETORI I 30-te I NJE ZERI **KRYENGrites, I NJE POEZIE GUXIMI**

Sot 30 vite më parë, kurajoja e një poeti nga Malësia ngriti krye mbi diktaturën, me poesi, me forcën e shpirtit.

Gjekë Marinaj me fjalë dhe zemër, me shpirt e guxim, u ngrit duke paraprirë, duke qenë preludi i një ndryshimi të themeltë.

Zëri i artit kishte nxitur revolucionare dhe ndryshime në gjithë botën, edhe në Shqipërinë e diktaturës më të egër, kjo kurajo, ky guxim do të ftonte 22-vjeçarin Gjekë Marinaj të deshmonte shpirtin dhe mendjen sfiduese.

Gazeta "DRITA", 19 Gusht 1990

Kështu e fillon Ndoc Gjetja faqen nr.10 të gazetës "Drita" të datës 19 Gusht 1990 tek rubrika "Autorë të rinj", duke botuar me poshtë katër poesi të Gjekë Marinajt, përkatësisht ato me tituj : "Mos më ik larg, poesi", "Vonesa e motrës", "Të paktën në èndërr..." dhe poezia e fundit e botuar atë dite vere ishte ajo me titull "Kuajt".

Ky ishte ai moment, kjo ishte ajo forcë shpërthyese e guximit të poetit dhe atyre që e botuan poezinë "Kuajt", poezinë që do të hynte në letërsinë shqipe të trysnuar nën diktat dhe censurë, si poezia që do të mbushte me forcë dhe besim të gjithë ata që shpresonin për liri dhe demokraci.

Rreth këti ngulmi Gjekë Marinaj do të citonte në "Illyria": "Unë besoj se kam filluar të shkruaj, jo se poezia është e rëndësishmë, por kam filluar të shkru-

aj, sepse besoja se poeti ishte i rëndësishëm. Për mua kur flitej se dikush ishte poet, më dukej se kishte dicka magjike. Madje, më duket se edhe sot ky imazh nuk ka ndryshuar. Kur dëgjoja për poetin, më dukej se flitej për diçka që krijonte një lidhje midis njeriut dhe zotit. Për mua poet ishte shkalla më superlativ e qënies njerëzore. Pastaj unë kam filluar të shkruaja dhe pak e nga pak e pashë se poezia po më ndihmonte shpirtërisht dhe pastaj e pashe se aty unë mund të shkëpusja dicka ngajeta e ta hidhja diku".

Gazeta "Zani i Malsisë" e ndjen për krenari dhe obligim të shpreh Gjekë Marinajt mirënjojen dhe falenderimin për poezinë dhe guximin, për shpirtin kryengritës malësor dhe energjinë përtëritëse të asaj tradite që ndezi në këto male, në këto zemra, në këto zjarre. Gjekë Marinaj dëshmoi me vepër kurajoje dhe urtësie atë që mëkuan me zemër dhe barut, që shpirti malësor, krenaria e këtyre maleve të jetë e lartësuar në trimëri dhe nderim, në dritë dhe guxim.

Sot pas 30 vitesh qëkur kjo poesi do të bëhej frymëzim dhe nxitës për shumë poetë dhe krijues, kemi fituar shumë beteja, por ende të tjera na mbeten për të fituar. Sfida e artit dhe e krijuesit për të paraprirë është një pishtar që u rrëfen udhën të gjithë atyre vullneteve që ngrihen dhe duke guxuar të ndeshen për një kauz të lartë, për një qëllim mirënjoës.

"Zani i Malsisë" më 19 Gusht 2020

KUAJT

Tërë jetën duke vrapiuar rrimë
Shohim veç përpara
Ç'bëhet prapa s'duam t'ia dimë.
Ne nuk kemi emër
Të gjithëve kuaj na thonë.
Nuk qajmë,
Nuk qeshim;
Heshtim,
Dëgjojmë;
Hamë atë ç'na japid,
Ecim nga na thonë,
Asnjë nga ne s'është mendje hollë.
Kush qe kalë mbreti,
Posti qe i lartë
Kush qe kalë princeshe
I bënë shalë të artë
Kush qe kalë fshatari
Pat samarë me kashtë
Kush qe kalë i egër
Tërë jetën fjeti jashtë.
Po qemë dhe mbetem kuaj, para njeriut!

